

Çka është transferimi i çmimit?

Transferimi i çmimit nënkupton përcaktimin e çmimit të mallrave dhe shërbimeve të shitura në mes të entiteteve të lidhura në mes veti.



Kush konsiderohen persona të lidhur?

Persona të lidhur konsiderohen personat, të cilët kontrollojnë njëra tjetrën 50% apo më shumë të aksioneve, ose janë nën kontroll të një personi të tretë, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi, ose kur personat janë të afërm të radhës së parë, të dytë apo të tretë sipas Ligjit mbi Trashëgiminë.

Kush është i obliguar për transfer të çmimit?

Të gjithë tatimpaguesit të regjistruar në Kosovë, të cilët janë të përfshirë në një apo më shumë transaksione të kontrolluara.

Çfarë janë transaksionet e kontrolluara?

Janë transaksionet që ndodhin në mes të dy ndërmarrjeve që gjenden në dy juridiksione të ndryshme tatimore dhe që konsiderohen që janë palë të lidhura.


Çka kuptojmë me vlerën e hapur të tregut?

Vlera e hapur e tregut për qëllime të transferimit të çmimit është çmimi i produktit të shitur apo shërbimit të ofruar ndërmjet palëve të lidhura, e cila duhet të jetë e njëjtë sikur palët të mos ishin të lidhura.

Si zbatohet vlera e hapur e tregut për qëllime të transferimit të çmimit?

Zbatimi i vlerës së hapur të tregut bazohet në një krahasim të kushteve në transaksionet e kontrolluara me kushtet e transaksioneve të krahasueshme të pakontrolluara.

Cilët faktorë duhet të merren parasysh për analizën e krahasueshmërisë?



Cilat janë metodat e transferimit të çmimit?

Metodat tradicionale të transaksionit

Metoda	Çfarë krahason?
Metoda e çmimit të krahasueshëm të pakontrolluar	çmimin
Metoda e çmimit të rishitjes	nivelin e fitimit bruto
Metoda e koston plus	nivelin e fitimit bruto

Metoda e marzhit neto të transaksionit	nivelin e fitimit neto
Metoda e ndarjes së fitimit	profitin bruto; profitin neto; të dhënat e jashtme/brenshme

Metodat transaksionale të fitimit

Çka është gama e tregut?

Gama e tregut është një grup treguesish financiarë përkatës, p.sh., çmimet, marzhet apo pjesët e fitimit, të nxjerra nga aplikimi i metodës më të përshtatshme të transferimit të çmimit për një numër transaksionesh të pakontrolluara, ku secili është pothuajse njëllëj i krahasueshëm me transaksionin e kontrolluar.

Çka është pala e testuar?

Pala e testuar është palë në transaksionin e kontrolluar, për të cilin treguesi financiar (marzha në kosto, marzha bruto apo treguesi i fitimit neto) po testohet.

Si bëhet përzgjedhja e palës së testuar?

Si rregull i përgjithshëm, pala e testuar është palë në transaksionin e kontrolluar, për të cilin njëra nga metodat e transferimit të çmimit mund të zbatohet në mënyrën më të besueshme, dhe për të cilën mund të identifikohen transaksionet më të besueshme të krahasueshme të pakontrolluara.

Te cilat metoda përdoret pala e testuar?

Metoda kosto plus;
Metoda e çmimit të rishitjes; dhe
Metoda e marzhës neto të transaksionit

Si bëhet përzgjedhja e metodës më të përshtatshme?

Fillimisht përdoret metoda krahasuese e çmimeve të pakontrolluara dhe në rastet kur kjo metodë nuk mund të shfrytëzohet, përdoren metodat e tjera më të përshtatshme dhe nuk kërkohet të aplikohet më shumë se një metodë.

Në cilën metodë ATK bazohet fillimisht?

ATK, për të vërtetuar se kushtet e transaksionit të kontrolluar janë në përputhje me parimin e tregut, bazohet në metodën e transferimit të çmimit të zbatuar nga tatimpaguesi, dhe nëse provohet e kundërta, përdoret metodë tjetër.

Kur konsiderohet se transaksioni i shërbimit është në përputhje me parimin e tregut?

Transaksion i shërbimit të ofruar/pranuar konsiderohet në përputhje me vlerën e hapur të tregut:

- nëse shërbimi është dhënë, në fakt është paguar;
- nëse shërbimi do të ofrojë një vlerë ekonomike;
- nëse marrësi i shërbimit do të ishte i gatshëm të paguante për të nga një palë e pavarur; dhe
- nëse vlera e shërbimit korrespondon me vlerën për të cilën mund të dakordohen palët e pavarura.

A aplikohet qasja e thjeshtësuar për shërbimet me vlerë të ulët të shtuar brenda grupit?

Për shërbimet brenda grupit me vlerë të ulët të shtuar, ofruesi i shërbimeve brenda kompanisë shumëkombëshe do të aplikojë një marzhë prej 7% në të gjitha shpenzimet e grumbulluara.

Kur bëhet rregullimi i transferimit të çmimit?

Rregullimi për transfer të çmimit bëhet në rastet kur treguesi financiar nga transaksioni i kontrolluar është jashtë gamës së tregut.

Çka janë rregullimet përkatëse?

Rregullimet përkatëse paraqiten kur në kushtet e transaksioneve të kontrolluara bëhet një rregullim nga organi tatimor i një vendi tjetër i cili rezulton në tatuarjen e fitimeve në atë vend, të cilat fitime tashmë janë tatuar në Kosovë. Nëse vendi që propozon rregullimin ka një marrëveshje me Kosovën për eliminimin e tatimit të dyfishtë, atëherë në këto kushte ATK-ja, pas dorëzimit të një kërkesë nga tatimpaguesi kosovar, kontrollon përputhshmërinë e atij rregullimi me vlerën e hapur të tregut.

Kush duhet të raportojë transaksionet e kontrolluara?

Tatimpaguesi i përfshirë në transaksione të kontrolluara, përfshirë tepricat e huave, të cilat brenda vitit fiskal kalojnë shumën prej 300,000 Euro, është i obliguar të plotësojë dhe dorëzojë në ATK formularin "Njoftimi i transaksioneve vjetore të kontrolluara".

Kur është afati për dorëzimin e njoftimit vjetor për transaksionet e kontrolluara?

Njoftimi vjetor dorëzohet së bashku me deklaratën vjetore dhe pasqyrat financiare, në formë fizike ose elektronike, më së largu me 31 Mars të vitit pasues.

Kur duhet të dorëzohet dokumentacioni për transfer të çmimit?

Dokumentacioni i transferimit të çmimit duhet t'i vihet në dispozicion ATK me kërkesë të saj, brenda tridhjetë (30) ditëve nga pranimi i kërkesës.

Çka përfshin dokumentacioni për transferim të çmimit

- përmbledhjen e aktiviteteve të tatimpaguesit
- përshkrimin e strukturës organizative të korporatës së grupit, në të cilin tatimpaguesi është anëtar
- përshkrimin e transaksioneve të kontrolluara
- sqarim për përzgjedhjen e metodës më të përshtatshme të transferimit të çmimit dhe të treguesit financiar
- analizën e krahasueshmërisë
- shpjegimin e çdo analize ekonomike dhe projekti mbështetës
- konkluzioni për përputhshmërinë e kushteve të transaksioneve të kontrolluara me parimin e tregut
- çdo informacion tjetër që mund të ketë një ndikim material në përcaktimin e përputhshmërisë së tatimpaguesit me parimin e tregut në lidhje me transaksionet e kontrolluara

Kontakti:

Administrata Tatimore e Kosovës
Rruga: Këndi i rrugëve Dëshmorët e Kombit & Bill Clinton

Tel: 038 200 250 71

Email: transferpricing@atk-ks.org



Administrata Tatimore e Kosovës
Poreska Administracija Kosova
Tax Administration of Kosovo

TRANSFERIMI I ÇMIMIT

